



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

Korçë, më 31.01.2018

### SHPLLJE REKURSI

Në lidhje me çështjen Civile me nr. vendimi 272, date 01.02.2008 të Gjykatës së Rrethit Korçë, me pale padites Theodhora Plasoti, te paditur Naum Ziko, etj eshte ushtruar rekurs i dates 17.07.2017, nga Naum Ziko dhe Tanci Ziko.

Bëhet kjo shpallje Rekursi në bazë të nenit 133/a, gërma b, të Kodit të Procedures Civile për tu afishuar në qendrën e banimit, e cila vlen si komunikim për banorët

- 1- Donika Plasoti,
- 2- Johana Plasoti,
- 3- Ornela Plasoti,
- 4- Helidion Plasoti

Bashkia Shijak, Lagjia Erzen

U shpall më dt 07.02.2018

KANCELAR  
Esmerald XHAFI



Bashkia Shijak

KRYETARI

Ardian



Korce, më 17 /07/ 2017

GJYKATA E RRETHIT  
GJYQESOR KORCE  
NR.  
DATA 17.07.2017  
K/S INAPELTEKII

**REKURS**

**KERKUES Naum Ziko**, i biri i Kristaqit dhe Marjanthit, dtl.1949, banues ne  
Korce, Rr" Sotir Mero" nr.31.

**Tanci Ziko**, e bija e Gaqos dhe Pandores, dtl.1953, banuese  
Korce, Rr" Sotir Mero" nr.31.

**OBJEKTI: Ndryshimin e Vendimit Nr.203, date 20.06.2017, Gjykata  
Apelit Korce.  
Ndryshimin e Vendimit Nr.272, date 01.02.2008, Gjykata e  
rrethit gjyqesor Korce**

**BAZA LIGJORE:** Neni 472, 485/d i K.Pr Civile,

**Palët Ndërgjyqëse:**

**Paditësa:** Naum Ziko, Tanci Ziko.

**TE paditur:** Z.R.K.K.Pronave Qarku Korce, Kristaq Plasoti etj.

**Objekti:** Pavlefshmeri akti administrativ .

**PERPARA GJYKATES SE LARTE****TIRANE**

**Të nderuar anetarë të Trupit Gjyqes !**

Kërkojmë : Prishjen e Vendimit Nr.203, date 20.06.2017, Gjykata Apelit  
Korce, Prishjen e Vendimit Nr.272, date 01.02.2008, Gjykata e rrethit  
gjyqesor Korce pasi nga Gjykata:

- 1) Nuk eshte respektuar dhe zbatuar ligji (neni 472 i K.Pr.Civile)
- 2) Nuk eshte respektuar nenit 10 i K.Pr. Civile( Gjykata mbeshtet vendimin e saj vetem mbi faktet qe jane paraqitur gjate procesit gjyqesor).
- 3) Nuk eshte respektuar neni 11 i K.Pr.Civile. Gjykata nuk ka marre parasysh disa prova te rëndësishme per ceshtjen: Vertetimi i pronesise nr.244/1 dt.25.09.1929, Kontrate Shit-Blemje dt. 26.10.1943, Akt -Shitje dt.24.09.1929.

-Gjykata e rrethit gjyqesor Korce me Vendim Nr.272,date 01.02.2008 ka vendosur:

Rrezimin e kerkese-padise te paditesave Naum Ziko dhe Tanci Ziko, te paditur Z.R.K.K.Pronave Qarku Korce, Kristaq Plasoti etj. Objekti-Pavlefshmeri akti administrativ "Vendim nr.720 dt.24.03.1995 te K.K.K.Pronave Bashkia Korce".

-Kunder Vendimit Nr.272,date 01.02.2008 te Gjykates se rrethit gjyqesor Korce kemi paraqitur ankim ne Gjykata e Apelit Korce, e cila me Vendim Nr.279,date 25.06.2010 ka lene ne fuqi Vendim Nr.272,date 01.02.2008 te Gjykates se rrethit gjyqesor Korce.

-Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Korce kemi bere rekurs ne Gjykata e Larte Tirane, e cila me Vendim nr.328 dt.04.06.2014 ka vendosur prishjen e Vendimit Nr.279,date 25.06.2010 te Gjykates se Apelit Korce dhe dergimin e ceshtjes per rishqyrtim ne po ate Gjykate me tjetër trup gjykues.

-Gjykata e Apelit Korce me Vendim nr.203 dt.20.06.2017 ka lene ne fuqi Vendimin Nr.272,date 01.02.2008 te Gjykates se rrethit gjyqesor Korce duke mos pranuar kerkesen ankimore te paditesave, pasi e konsiderojne si te pabazuar ne prova dhe ligj.

Paraqesim kete rekurs para Kolegjit civil te Gjykates se Larte, pasi nuk jemi dakort me Vendimin nr.203 dt.20.06.2017 te Gjykates se Apelit Korce, pasi eshte nje vendim i gabuar, i pambeshtetur ne ligj dhe prova. Arsyet per te cilat nuk jemi dakort po i parashtrojme sa me poshte vijon:

- Ne Paditesat Naum Ziko dhe Tanci Ziko me provat qe paraqitem gjate gjykimit te ceshtjes konkretisht : Vertetim nr.76 regj. dt.30.01.1992 provuam para Gjykatave se me Vendim nr.119 dt.19.06.1961 te Komitetit ekzekutiv te K.P. te qytetit te Korces, Kico Rafail Ziko(babai i paditesit Naum) i eshte shpronesuar nje godine, avllite dhe trualli me siperfaqe 850 m2, e ndodhur ne Lagj.2, Rr"Bulevardi Republika", nr.47 Korce. Si kompensim per kete shpronesim nga shteti na eshte dhene nje shtepi tjetër ne Lagj.1 te Korces (shtepia objekt gjykimi) Rr"Sotir Mero" me kufij: L/Koste Sholla, P/Mihallaq Hance,J/Rr.Sotir Mero, V/Jorgji Gjoka. Meqenese prona e shpronesuar ka pasur vlere me te vogel se shtepia me te cilen u kompensua, babai im Kico Rafail Ziko ka paguar ne favor te personit juridik te shtetit shqiptar edhe diferencen e vlefes prej 125859 lek, shume e cila do shlyhej brenda 3 vjeteve. Ne shtepine objekt gjykimi ne paditesat kemi banuar qe kur u shpronesua prona ne vitin 1961, por K.K.K.Pronave Bashkia Korce me Vendim nr.720 dt.24.03.1995, ja ka kthyer te paditurve. Duke qene se vendimi i K.K.K.Pronave Korce ka qene i gabuar jemi detyruar te iniciojme kete gjykim i cili ka evoluar sic e pershkruam me lart.

**Pse themi se Vendimi nr.203 dt.20.06.2017 i Gjykates se Apelit Korce eshte i gabuar?**

**E para:** Gabimi i Vendimit te Gjykates se Apelit Korce fillon qe ne fleten e pare persa i perket emrave te gjyqtareve qe kane gjykuar ceshtjen: Kryesues-

Entela Prifti, Anetar-Etleva Temo, Anetar-Brunilda Orhani. Shohim fleten e fundit te vendimit te Gjykates: Kryesuese-Etleva Temo, Anetare-Saida Dollani, Anetar-Amarildo Laci. Ne momentin qe Gjykata ka gabuar edhe ne emrat e gjyqtareve, se dime se si kjo Gjykate mund te zgjidhe drejt dhe paanesi ceshtjen per gjykim.

**E dyta:** Gjykata e Apelit Korce eshte kontradiktore ne ato cka thote: nga njera ane ajo arsyeton ne vendimin e saj se paditesat legitimohen ne ngritjen e padise, pasi kane shlyer vleren prej 125859 lek per 1/2 pjese te shtepise objekt gjykimi, ku nga Vertetimi i deges se finances Korce dt.09.06.1987 rezulton e provuar se babai i paditesit Z.Kristaq Rafail Ziko ka shlyer detyrimin kundrejt shtepise se marre ne kompensim dhe nuk figuron te jete debitor. Nga ana tjeter Gjykata e Apelit Korce vendosi lenien ne fuqi te Vendimit Nr.272, date 01.02.2008 te Gjykates se rrethit gjyqesor Korce, ku sipas kesaj Gjykate pala paditese nuk legitimohet ne ngritjen e kesaj padie.

**E treta:** Gjykata e Apelit Korce arsyeton ne vendimin e saj se: sipas Vertetimit te pronesise nr.244/1 dt.25.09.1929 rezulton se 1/2 pjese e pronave te konfiskuara ish pronarit Thoma Plasot, kane ne kufirin lindor shtepine e Thoma Plasotit, pra 1/2 pjese tjeter te prones ne momentin e konfiskimit e dispononte vete pronari Thoma Plasoti.

Konkluzioni ne te cilin ka arritur Gjykata lidhur me pronesine e 1/2 pjese te baneses object gjykimi, duke u nisur vetem nga nje kufitar eshte shume i gabuar. Kjo per faktin se: **Eshte e vertete qe ne Lindje eshte shtepia e Thoma Plasotit, por sqarojme se nuk behet fjale per te njejten shtepi, por behet fjale per shtepine me nr.33 te cilen e ka pasur Thoma Kosta Plasoti duke e blere nga Leonidha Kosta Karamitro, gje u cila u provua ne gjykim nga Vertetimi i pronesise nr.244/1 dt.25.09.1929, ku shtepia ka keto kufij: Djathtas/udhe, majtas shtepi e trashegimtareve te Jorgji Thanas Jances, perpara udhe publike dhe prapa shtepi e Nako Koste Karamitro.**

**Po te shohim ne Vertetimi i pronesise nr.244/1 dt.25.09.1929 majtas thote: shtepia e trashegimtareve te Jorgji Thanas Jances, kjo pasi ne 1929 shtepia object gjykimi nr. 31 ishte e Jorgji Thanas Jances (babai) i Nikollaq Jorgji Hance(shitesi ne Kontrata e shitblerjes dt. 26.10.1943). Ne vitin 1943 me ane te Kontrates se shitblerjes dt. 26.10.1943 nga Sofia Tasho e bija e Thoma Tasho dhe e shoq'e Thoma Plasotit (Bleresja), blihet 1/2 pjese te pandare e pronave te percaktuara ne kontrate nga (Shitesi) Nikollaq Jorgji Hance.**

Gjithashtu, Gjykata shprehet se ne vitin 1948 kur u konfiskua 1/2 e baneses, gjysmen tjeter e perdorte familja e Thoma Plasotit. Gjate gjykimit nuk rezultoi e provuar ky fakt, pasi nuk u paraqit asnje prove prej pales se paditur per ta provuar. Pala e paditur prapesimet e saj i mbron vetem me fjale. Por per te provuar prapesimet duhen prova dhe fakte, gje e cila eshte e percaktuar edhe ne Nenin 11 te K.pr.civile ne te cilin eshte e parashikuar se:

"Provat jane te dhena qe merren ne formen e parashikuar nga ky kod dhe qe vertetojne ose rrezojne pretendimet ose prapesimet e pjesemarrësve ne process".

**E katerta:** Gjykata e Apelit Korce shprehet se Vendimi nr.720 dt.24.03.1995 i K.K.K.pronave Korce" eshte nxjerre ne perputhje me kriteret e parashikuara nga Ligji 7698, dt.15.04.1993 "Per kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronareve", i ndryshuar ne nenin 1 te te cilit parashikohet :Ky ligj u njih ish pronareve apo trashegimtareve te tyre, te drejten e pronesise per pronat e shtetezuara, te shpronesuara apo te konfiskuara sipas akteve ligjore(duke perfshire edhe Ligjin nr.37 dt.31.01.1945"Per tatimin e jashtezakonshem") nenligjore e vendimeve te Gjykates te dale pas dt.29.11.1944, ose te marra pa te drejte nga shteti me cdo menyre tjeter dhe percakton menytrat dhe masat per kthimin dhe kompensimin e tyre".

**Ky qendrim i Gjykates se Apelit Korce eshte i gabuar se:** Megjithese me Ligjin nr.7916 dt.12.04.1995 rrethit te subjekteve te parashikuara ne piken Ite Ligjit 7698, dt.15.04.1993 ju shtuan edhe personat qe shteti u kishte marre pronat ne zbatim te Ligjit nr.37 dt.31.01.1945"Per tatimin e jashtezakonshem", ky ligj u shfuqizua me Vendimin e Gjykates Kushtetuese nr.16 dt.17.04.2000.

Sqarojme se: Vendimi nr.720 dt.24.03.1995 i K.K.K.Pronave Korce" me te cilin te paditurve u eshte kthyer shtepia objekt gjykimi, ka dale me pare se Ligji nr.7916 dt.12.04.1995, ligj i cili rrethit te subjekteve te parashikuara ne piken Ite Ligjit 7698, dt.15.04.1993 i shtoi edhe personat qe shteti u kishte marre pronat ne zbatim te Ligjit nr.37 dt.31.01.1945"Per tatimin e jashtezakonshem".

Gjithashtu, Gjykata e Apelit Korce eshte kontradiktore ne arsyetimin e saj pasi: nga njera ane prej saj pranohet se nga pala paditese u paraqiten dokumenta qe ish pronari Thoma Plasoti i eshte nenshtuar parashikimeve te Ligjit "Per tatimin e jashtezakonshem", kurse nga ana tjeter shprehet se kjo nuk perben shkak ligjor qe trashegimtarete e Thoma Plasotit te mos perfitojne nga Ligji 7698, dt.15.04.1993 "Per kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronareve". **Ky qendrim i gjykates vjen haptazi ne kundërshtim me ligjin.**

Tatimi i jashtezakonshem vendosej per shtetasit per detyrimet me karakter fiskal, dhe nuk mund te barazoheshin me personat qe jane zhveshur me pa te drejte nga prona e tyre. Thoma Plasotit i jane marre me te drejte pronat prandaj trashegimtarete e tij nuk mund te jene subjekt i ligjit. K.K.K.Pronave Korce me Vendimi nr.720 dt.24.03.1995 ka vepruar ne kundërshtim me ligjin duke i kthyer shtepine objekt gjykimi, prandaj dhe duhet te anulohet .

**Vendimi nr.720 dt.24.03.1995 i K.K.K.Pronave Korce" eshte i gabuar edhe per faktin se, ne pjesen arsyetuese te tij komisioni shprehet se: Ne baze te Vertetimit te pronesise te Zyres se hipotekes Korce dt.22.10.1992, del ne pronesi te Thoma Koste Plasoti dhe Sofia Tasho**

**Plasoti ½ e shtepise objekt gjykimi, kurse ne dispozitiv i kthen te gjithë shtepine. A nuk eshte kontradiktore dhe haptazi ne shkelje te ligjit????**

Nga ne paditesat u paraqiten prova ne gjykim, me te cilat u provua se ish pronari Thoma Plasoti i eshte nenshtruar parashikimeve te Ligjit "Per tatimin e jashtezakonshem". Lidhur me kete moment duam te sqarojme se trashegimtaret e Thoma Plasotit nuk duhet te perfitojne nga Ligji 7698, dt.15.04.1993 "Per kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronareve", pasi ne nenin 24/1 te eshte e parashikuar se : "Nuk perfitojne nga ky ligj:ish bashkepunetoret e okupatoreve nazifashiste per pronat e vena gjate okupacionit, pas rishikimit te proceseve ose percaktimit te tyre si te tille prej Gjykates se Kasacionit". Lidhur me kete fakt Gjykata e Apelit Korce shprehet se, gjate gjykimit nuk ka rezultuar se ekzistojne akte provuese. Ky qendrim i Gjykates nuk eshte i drejte pasi provat te cilat ndodhen ne dosje provojne krejt te kunderten.

**E pesta:** Gjykata e Apelit Korce ka perseritur hetimin gjyqesor dhe ka caktuar grup ekspertesh. Prej Gjykates se Apelit Korce administrohen 3 Akte ekspertimi te ndryshem nga njeri -tjetri. Ajo ne dhenien e vendimit eshte bazuar ne pergjigjet e dhena nga ekspertet. Ekspertet ne aktet e tyre pasqyrojne te dhena te rreme te cilat nuk perputhen me te dhenat qe jane te pasqyruara ne provat, te cilat ndodhen ne dosjen gjyqesore. ***Gjykata ka anashkaluar pergjigjet e rreme qe kane dhene ekspertet ne aktet e ekspertimit dhe konkretisht:***

- **Ne Akti i ekspertimit I dhe II lidhur me pergjigjet e detyres 2 dhe 9** ekspertet jane shprehur se: Sipas Vertetimit te pronesise nr.244/1 dt.25.09.1929 ne emer te Thoma Koste Plasoti figuron e regjistruar nje shtepi banimi me gjithë eksardimet e saj ndodhur ne Korce, lagja Barc i vlleheve me kufij: J/Rr."Vilson" nr.31, V/shtepi e rruges se "Kongresi i Beratit "nr.26, L/shtepi e Thoma Plasoti, shtepi e Nako Karamitro dhe udhe me siperfaqe e gjatesi 33 m, P/Nikollaq Mihallaq Jance.

**E verteta eshte ndryshe**, por Gjykata e Apelit Korce nuk e ka vene re, pasi po te bejme krahasimin midis kufitareve te dhene nga ekspertet dhe kufitaret qe jane te pasqyruar ne **Vertetimin e pronesise nr.244/1 dt.25.09.1929** do te shohim: Djathtas/udhe, majtas shtepi e trashegimtareve te Jorgji Thanas Jances, perpara udhe publike dhe prapa shtepi e Nako Koste Karamitro.

- **Ne Akti i ekspertimit III ne pergjigja e detyres 3** te dhene nga gjykata(detyra 3:ne vitin 1955 banesa ke kishte pronar ligjor?) ekspertet jane shprehur se:

**Shites** eshte **Leonidha Koste Karamitro** dhe **Bleresi** eshte **Thoma Koste Plasoti**. Gjithashtu shprehen se ne te njejtin vertetim me numer transkriptimi nr. 26/24 dt.17.11.1955 i perket Kontrates se shitblerjes dt.24.09.1949.

Gjykata e Apelit Korce perseri nuk i ka vene re keto pergjigje te rreme te eksperteve, pasi **E verteta eshte ndryshe**: Ne Vertetimin e pronesis nr.244/1 dt.25.09.1929 ku ne themren e transkriptimit jane bere shenimet: u shit nje shtepi dhe u transkriptua ne nr. 26/24 dt.17.11.1955 ku **Shitesi** eshte **Shteti** dhe **Bleresi** eshte **Kosta Rapo Sholla**. Persa perket kontrates se shitblerjes kemi Kontraten dt.24.09.1929 dhe jo dt.24.09.1949.

- **Ne Akti i ekspertimit III ne pergjigja e detyres 5** te dhene nga Gjykata(detyra 5: Shtepia nr.31 perpara se te kalohej ne pronesi te Plasotit, kush ishte pronari i ligjshem i saj, document vertetues) ekspertet jane shprehur se: Sipas Kontrates se shitblerjes dt. 26.10.1943 me nr.transkriptimi 390/18 dt. 06.09.1943 shites rezulton **Leonidha Karamitro**.

Gjykata e Apelit Korce perseri vazhdon dhe vazhdon te mos i vere re keto pergjigje te rreme te eksperteve, pasi **E verteta eshte ndryshe**: Sipas Kontrates se shitblerjes dt. 26.10.1943 me nr.transkriptimi 390/18 dt. 06.09.1943 shites rezulton **Nikollaq Jorgji Hance**.

- **Ne Akti i ekspertimit III ne pergjigja e detyres 9** te dhene nga gjykata(detyra 9: si eshte rjedhoja e origjines te prones object gjykimi, objekti me nr.31 ose Kontrata e vitit 1943) ekspertet jane shprehur se: Sipas Vertetimit te pronesis dt. 22.10.1992 me nr.transkriptimi 390/18 i pergjigjet Kontrates se shitblerjes dt.26.10.1943 ku **Sofia Tasho(Bleresja)**, blen  $\frac{1}{2}$  pjese te pandare ku **Shites** rezulton **Leonidha Karamitro**.

Gjykata e Apelit Korce nuk ka se si te vcre re keto pergjigje te rreme te eksperteve pasi i ka marre te mireqena jane apo s'jane te verteta, por **E verteta eshte ndryshe**: Ne Kontrata e shitblerjes dt.26.10.1943 **Sofia Tasho** e bija e Thoma Tasho dhe e shoq'e Thoma Plasotit (**Bleresja**), blen  $\frac{1}{2}$  pjese te pandare te pronave te percaktuara ne kontrate nga (**Shitesi**) **Nikollaq Jorgji Hance** dhe jo **Leonidha Karamitro**.

Gjykata vazhdon mandej se pala e paditur ka dokumenta te plota pronesis sic jane: Vertetimi i pronesis nr.244/1 dt.25.09.1929 dhe Kontrate shitblerjes dt. 26.10.1943 ku Sofia Tasho blen  $\frac{1}{2}$  pjese te pandare nga shitesi Leonidha Karamitro.

Te dhenat e rreme qe u pasqyruan ne aktet e ekspertimit nga ekspertet, tani po vazhdojne te permenden edhe nga Gjykata, pasi ajo duhet te shohe mire Kontraten e shitblerjes dt. 26.10.1943 sepse kemi te pasqyruar qarte dhe paster, e zeza mbi te bardhen se :**Sofia Tasho e bija e Thoma Tasho dhe e shoq'e Thoma Plasotit (Bleresja), blen  $\frac{1}{2}$  pjese te pandare te pronave te percaktuara ne kontrate nga (Shitesi) Nikollaq Jorgji Hance dhe jo Leonidha Karamitro.**

**E gjashta:** Prej Gjykates se Apelit Korce eshte shkelur neni 302 i K.Pr.Civile ne te cilin eshte e parashikuar se: "Pasi te jene shqyrtuar te gjitha provat qe Gjykata ka pranuar te merren, pyeten palet nese kane kerkesa te tjera ne dobi te gjykimit te ceshtjes dhe, ne rast se ato pranohen , Gjykata i jep fund hetimit gjyqesor te ceshtjes dhe fton palet te parashtrojne pretendimet perfundimtare te tyre rreth ceshtjes ne gjykim, Si rregull ato i parashtrohen

*Gjykates me shkrim, me kerkesen e paleve kur kjo shuhet me vend, Gjykata u jep atyre nje afat deri ne 5 dite, per te pergatitur parashtresat e tyre".*

Themi eshte shkelur neni 302 i K.Pr.Civile, pasi po te shohim daten e Aktit te ekspertimit te trete eshte dt.20.06.2017, edhe Vendimi i Gjykates se Apelit Korce eshte i dt.20.06.2017. Gjykata jo vetem qe nuk na ka lejuar qe te shprehemi lidhur me aktin e ekspertimit, por nuk na ka dhene as kohe, afatin 5-ditor per t'u pregatitur per konkluzionet perfundimtare, te drejte qe na e njej ligji(neni 302 i K.PR.Civile).

Gjithashtu, Gjykata e Apelit Korce nuk na ka dhene kohe per t'u njohur me permbajtjen e aktit te ekspertimit te pare dhe te dyte, me qellim qe te benim edhe ne kontestimet tona lidhur me keto akte.

Sqarojme Gjykatën e Lartë Tirane se nuk kemi qene te pranishem ne asnje nga te tre rastet kur eshte kryer kqyrja e objektit ne teren, gje e cila vjen ne kundërshtim me nenin 228 te K.Pr.Civile, ne te cilin kemi te percaktuar se: *"Kur ekspertimi kryhet pa pjesemarrjen e Gjykates, eksperti duhet te hartoje nje raport me shkrim mbi ekspertizen e kryer, ne te cilen duhet te gjejne pasqyrim edhe verejtjet e kerkesat e paleve".*

Ne Akti i ekspertimit I ne fq.3 ekspertet jane shprehur se: *Mbi bazen e ketij dokumentacioni, ne prezence te paleve kqyrem terenin.*

Ne pergjigja e detyres 1 jane shprehur se: *Mbi bazen e ketij dokumentacioni, ne prezence vetem te pales se paditur.* Gjithashtu, ekspertet shprehen ne pergjigja e detyres 1 se, pala paditese ishte njoftuar nepermjet avokatit te tyre por nuk erdhen.

**E verteta eshte krejt ndryshe:** Ne Paditesat nuk jemi njoftuar asnjehere nga ekspertet per daten dhe oren kur do te kqyrnin objektin dhe, nuk kemi pasur asnjehere avokat me ane te te cilit mund te njoftoheshim sic shprehen ekspertet.

**E shtata:** Lidhur me detyren e lene nga Gjykata e Lartë Tirane, e cila ka te beje me faktin nese shtepite nr.31 dhe nr.33 jane e njejta shtepi apo te ndara nga njera tjetra, sqarojme se ekspertet ne Aktet e ekspertimit te pare dhe te dyte nuk kane kthyer pergjigje. Ne Akti i ekspertimit te trete ekspertet jane pergjigjur: ***Jane dy objekte te ndryshme dhe bashkelidhur aktit kane paraqitur planimetrine e bodrumit, nderkohe qe duhet te benin planvendosjet per secilin object sipas detyrave te Gjykates.***

Se fundmi, Gjykata Apelit Korce arsyeton se pala paditese i ka realizuar te drejtat e saj me Vendimin nr.339/1 dt.02.06.1995 i K.K.K.Pronave Bashkia Korce". Sqarojme se vendimi i lartpermendur nuk ka lidhje me shtepine nr.31 objekt gjykimi.

Nga te gjitha sa permendem me siper perfundimisht:

I Kërkojme Gjykatës së Lartë Tirane, pas shqyrtimit te çështjes , në zbatim te nenit 472, 485/d te K.Pr.Civile te vendose :



- Pranimin e Rekursit te paraqitur nga paditesat Naum Ziko dhe Tanci Ziko.
- Ndryshimin e Vendimit Nr.203,date 20.06.2017, Gjykata Apelit Korce.
- Ndryshimin e Vendimit Nr.272,date 01.02.2008, Gjykata e rrethit gjyqesor Korce
- Pranimin e padise se paditesave Naum Ziko dhe Tanci Ziko.

Me konsiderate,

**PADITESAT**

**Naum ZIKO**



**Tanci ZIKO**





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

*zak. n. 100*  
*sek. z. 100*  
N. 334 Prot  
D. 05.02.2018

Korçë, më 31.01.2018

### SHPLLJE REKURSI

Në lidhje me çështjen Civile me nr. vendimi 272, date 01.02.2008 të Gjykatës së Rrethit Korçë, me pale padites Theodhora Plasoti, te paditur Naum Ziko, etj eshte ushtruar rekurs i dates 17.07.2017, nga Naum Ziko dhe Tanci Ziko.

Bëhet kjo shpallje Rekursi në bazë të nenit 133/a, gërma b, të Kodit të Procedures Civile për tu afishuar në qendrën e banimit, e cila vlen si komunikim për banorët

- 1- Donika Plasoti,
- 2- Johana Plasoti,
- 3- Ornela Plasoti,
- 4- Helidion Plasoti

Bashkia Shijak, Lagjia Erzen



U shpall më dt 07.02.2018

KANCELAR  
Esmerald XHAFI



Bashkia Shijak  
KRYETAR  
Arolian  
*[Signature]*